



KOMUNA - MITROVICË

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KONTRATË PUBLIKE KORNIZË – PUNË

TITULLI I KONTRATËS

Mirëmbajtja, Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet.

AUTORITETI KONTRAKTUES: **KOMUNA E MITROVICËS.**

OPERATORI EKONOMIK: Gani Mlinaku B.I., Adresa: PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, 40000, MITROVICË,

Nr ¹ i prokurimit	642-19-4378-5-1-1
Nr i brendshëm	642/19/029/511

PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË², KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË Mirëmbajtja, Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet. Nr i prokurimit: 642/19/4378/511 & Numri i brendshëm: 642/19/029/511 – PUNË

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË.

KOMUNA- MITROVICË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

OPERATORI EKONOMIK: Gani Mlinaku B.I.,PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, 40000, MITROVICË, me nr të Biznesit: **810618043**

me titull

Mirëmbajtja,Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet..

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike kornizë për Mirëmbajtja,Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet. si në vijim:

Mirëmbajtja,Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet.

me numër identifikues: Nr i Prokurimit: **642-19-4378-5-1-1**

Nr i brendshëm: **642-19-029-511**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve për **Mirëmbajtja,Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet** në vijim:

Mirëmbajtja,Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet.

Autoriteti kontraktues kryen punë vetëm në emër të vet-Komuna e Mitrovicës ose

Autoriteti kontraktues kryen punë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese]

Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetin Kontraktues të Komunën e Mitrovicës të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryjë punë ose të kryej mirëmbajtje në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorinë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **[08/10/2019]** dhe përfundon me **[07/10/2022]**.

Neni 2 Koha e përfundimit

² Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë **[1095] ditë ose 36 muaj ose 3 vjet** nga koha e nënshkrimit nga te dy palët lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë i gjithë [territori i Qytetit të Mitrovicës] te gjitha trotualet, pjesët e gjelëbruara te qytetit dhe Parqet sipas punëve te cilat i cakton Njësia kërkuese(DSHPI).

Në rast se Autoriteti kontraktues kryen punë ose mirëmbajtje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese shëno .Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit-rrugët,rrugicat dhe Sheshet e qytetit të Mitrovicës.N/A .

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve të gjelëbrimit janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Oferta sipas qmimeve për njësi i cila i baskangjitet Kontratës dhe në bazë te cilave qmime do te bëhet faturirimi ndësa qmimi TOTAL i kontratës është: **1.200.000,00 € (Një milion e dyqindë mijë euro e 00/100)**. Devijimi i lejuar nga vlera kontratës (tavani) është : **+ --30 % .[plus-minus]**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me email, postë, mesazh, telefaks, faks, ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Shqipe]³ në katër[4]origjinale,3(tri) për Autoritetin Kontraktues dhe një(1) për Kontraktuesin si vijon:

Një(1) Original për Njësën Kërkuese(DSHPI),Një(1) Original për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa,
Një(1) Original për Drejtorinë e Prokurimit dhe Një(1) Original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna-Mitrovicë	
Emri:	Haxhimet FERATI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08/10/2019
Vula:	

Për Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.	
Emri:	Agim BAHTIRI-ZKA
Pozita:	Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
Nënshkrimi:	
Data:	08/10/2019
Vula:	

Për Kontraktorin: Gani Mlinaku B.I., PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, 40000, MITROVICË	
Emri:	Gani MLINAKU
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	08/10/2019
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE] .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% të vlerës së Kontratës në shumën prej: 120.000,00 € me kohëzgjatje prej 37 muajsh.
Përgjegjësia dhe obligimet e garancionit	11.2	Punëkryesi garanton që punët janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara teknike. Punëkryesi garanton që punët do të kryhen pa asnjë defekt sasior apo cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve punëkryesi do të bëjë përpjekje maksimale për përmirsim të menjëhershëm të tyre.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Azhurnimi-Periudha e Intervenimit	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [1] ditë ose 24 orë pas marrjes së porosisë dhe një kërkesë nga ana e AK do të jetë efektiv për intervenim ose kryerjes së punëve sipas kërkesës së Drejtorisë kërkuese.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë [10/10/2019]
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë [1095] ditë ose 36 muaj ose 3 vjetë deri më 07/10/2022.
Regjistri i punës	20.1	Rrënimi i objekteve pa leje do të kryhet sipas kërkesave të Drejtorisë kërkuese të cilat kërkesa do të aprovohen nga kjo Drejtori dhe Kuvendi dhe do të zbatohen nga Inspektorët e Drejtorisë së Inspektionit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit nga Drejtoria për Shërbime publike është caktuar Mehmet BAJRAMI nr i tel :049/ 540-650] mehmet.bajrami@rks-gov.net

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË Mirëmbajtja, Ngritja dhe Revitalizimi i sipërfaqeve të Gjelëbruara dhe parqeve në qytet. Nr i prokurimit: 642/19/4378/511 & Numri i brendshëm: 642/19/029/511 – PUNË

Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>[N/A]vetëm në raste specifike për paisjet te cilat nuk mund te sigurohen në vend .</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[N/A]nuk është parapa me dosjen e tenderit dhe në Anexet përkatse.</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [5] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është [365] ditë 12 muaj ose një vitë nëse gjatë gjatë kryerjes së punëve është bërë ndonjë dëm i pa parashikuar dhe O.E. ka qenë i vetëdijshëm për pasojat O.E. duhet të sanoj në kohën e paraparë të cekur më lartë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët ose të realizojë punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së Punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Qdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e te cilat mund te lindin gjatë ekzekutimit të punëve të kësaj kontrate është e mundur te zgjidhet në mënyr miqësore,përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues–Komuna Mitrovicës dhe personat përgjegjës të kontraktorit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata kompetente në Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].ndërkombëtarisht]]